

RREGULLORE

“PËR PROCEDURAT DISIPLINORE TË KËSHILLTARËVE TË NJËSISË SË SHËRBIMIT LIGJOR TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT”

Në bazë të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 9 dhe nenit 22, pika 5, e rregullores “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, të nenit 37 të Kodit të Punës dhe të Kodit të Procedurave Administrative, mbledhja e Komisionit, miraton rregullat procedurale e materiale të procesit disiplinor që ndiqet ndaj këshilltarëve të njësisë së shërbimit ligjor të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

1. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat procedurale e materiale në një procedurë disiplinore, organet kompetente të përfshira në këtë procedurë, mënyrën e vendimmarrjes përfundimtare për dhënien e masës disiplinore ndaj këshilltarit të njësisë së shërbimit ligjor të Komisionit.

2. Në kuptim të kësaj rregulloreje:

a) Me “procedurë disiplinore” do të kuptohet gjithë veprimtaria administrative, që kryhet që nga momenti i konstatimit të një shkeljeje disiplinore, vënies në dijeni me shkrim të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, organin që zhvillon procedurën disiplinore, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga organi kompetent.

b) “Organ epror” për këshilltarin e njësisë së shërbimit ligjor është komisioneri, pranë të cilit është caktuar/emëruar këshilltari ligjor/ekonomik, sipas vendimmarrjes së mbledhjes së Komisionit.

c) “Organ vendimmarrës disiplinor” është mbledhja e Komisionit.

d) Organi që shqyrton shkeljen disiplinore është “Komiteti disiplinor *ad hoc*” (më tej Komiteti disiplinor), i ngritur për këtë qëllim. Komiteti disiplinor mblidhet, organizohet dhe funksionon në bazë të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale.

3. Procedura disiplinore fillon me një njoftim/kërkesë me shkrim nga komisioneri, si epror direkt i këshilltarit të njësisë së shërbimit ligjor, të cilën ia drejton kryetarit dhe mbledhjes së Komisionit. Kërkesa/njoftimi me shkrim duhet të përmbajë:

a) përshkrimin e veprimit/mosveprimit konkret që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij;

b) provat konkrete ku mbështetet shkelja e pretenduar, bashkëlidhur;

c) propozimin për ngritjen e komitetit disiplinor *ad hoc* që do të zhvillojë procedurën disiplinore për shqyrtimin e shkeljes së pretenduar.

4. Komiteti disiplinor *ad hoc* përbëhet nga 3 anëtarë, të caktuar me short nga mbledhja e Komisionit në mbledhjen më të afërt. Eprori direkt i këshilltarit merr pjesë si palë në proces.

Komiteti disiplinor asistohet nga specialisti i njësisë së burimeve njerëzore, i cili është prezent gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore dhe mban e administron aketet dhe procesverbalet e punës së komitetit disiplinor.

5. Brenda 2 ditëve nga krijimi i komitetit disiplinor, sekretariati i tij, përgatit njoftimin me shkrim drejtuar këshilltarit ndaj të cilit pretendohet kryerja e shkeljes disiplinore.

Njoftimi me shkrim duhet të përmbajë:

a) fillimin e procedurës disiplinore dhe përbërjen e komitetit disiplinor *ad hoc*;

b) shkeljen e pretenduar nga eprori dhe rrethanat e kryesjes;

c) provat me shkrim mbi të cilat mbështetet shkelja e pretenduar;

ç) të drejtën për të paraqitur prapësimet me shkrim dhe provat brenda 5 ditëve pune, nga marrja e njoftimit me shkrim për paraqitjen e tyre në seancë dëgjimore;

d) vendi, data dhe ora e seancës dëgjimore;

6. Këshilltari, ndaj të cilit ka filluar procedura, gëzon të drejtat e palës në procedim, njoftohet me shkrim dhe dëgjohe nga komiteti disiplinor në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Në seancën dëgjimore mbahet procesverbal me shkrim nga njësia e burimeve njerëzore, ose regjistrohet me mjetet *audio* dhe zbardhet. Procesverbali është pjesë e procesit disiplinor dhe administrohet në dosjen disiplinore në përputhje me ligjin.

Në rast mungese për shkaqe të arsyeshme, data e seancës dëgjimore shtyhet një herë të vetme, me 3 ditë pune, duke iu njoftuar me shkresë, e-mail zyrtar dhe personal, tek adresat e deklaruara në dosjen personale të këshilltarit, që administrohet nga njësia e burimeve njerëzore. Mosprezenca edhe datën e dytë të seancës dëgjimore, konsiderohet refuzim për t'u dëgjuar dhe evidentohet në raportin disiplinor përmbledhës që harton komiteti disiplinor *ad hoc*.

7. Brenda **5 ditëve** nga data e zhvillimit të seancës dëgjimore, komiteti disiplinor harton raportin përmbledhës për procedurën e ndjekur dhe propozimin për klasifikimin e shkeljes. Në çdo rast, për klasifikimin dhe llojet e shkeljeve disiplinore, gjejnë zbatim dispozitat e kreut V "Disiplina", të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit".

7. Komiteti disiplinor i përcjell kryetarit dhe mbledhjes së Komisionit, propozimin për klasifikimin e shkeljes dhe masën disiplinore në raportin disiplinor, i cili duhet të përmbajë:

- Përshkrimin e procedurës së ndjekur, shqyrtimin e shkeljes së pretenduar, provat/materialet e paraqitura nga komisioneri epror direkt, prapësimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga këshilltari nën procedim, si dhe propozimin e komitetit për klasifikimin e shkeljes dhe dhënien e masës disiplinore, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe këtë rregullore.

8. Mbledhja e Komisionit, shqyrton raportin disiplinor dhe vlerëson klasifikimin e shkeljes disiplinore të propozuar nga komiteti disiplinor, mban në konsideratë vlerësimin në tërësi të punës dhe sjelljes së këshilltarit nën procedim disiplinor, pasjen ose jo të masave të mëparshme disiplinore në dosjen personale të administruar nga njësia e burimeve njerëzore e Komisionit dhe me votim të shumicës së anëtarëve prezent në mbledhjen e Komisionit, vendos:

a) Rrëzimin e propozimit për dhënien e masës disiplinore, pasi shkelja e pretenduar nuk është kryer dhe është e pambështetur në ligj dhe prova;

b) pranimin e propozimit dhe dhënien e masës disiplinore sipas propozimit të komitetit disiplinor;

c) pranimin e propozimit, ndryshimin e klasifikimit të shkeljes disiplinore dhe dhënien e një mase mase disiplinore më të lehtë ose më të rëndë.

9. Vendimi përfundimtar i dhënies së masës disiplinore apo rrëzimit të propozimit për masë, merret me shumicën e votave të anëtarëve prezent në mbledhjen e Komisionit dhe pasqyrohet në procesverbal të posaçëm. Vendimi përfundimtar i dhënies së masës disiplinore, i përcillet këshilltarit të ndëshkuar me masë, me firmën e kryetarit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me cilësinë e punëdhënësit.

Vendimi për dhënien masës disiplinore duhet plotësojë kushtet e nenit 99 dhe 100 të Kodit të Procedurave Administrative dhe t'i njoftohet me shkrim këshilltarit të ndëshkuar me masë disiplinore, brenda 4 ditëve nga dhënia e tij.

10. Një kopje e vendimit të masës disiplinore i arsyetuar, së bashku me materialet shoqëruese, depozitohet pranë njësisë së burimeve njerëzore. Kopja e vendimit bëhet pjesë e dosjes personale të këshilltarit të ndëshkuar me masë disiplinore.

11. Përvec masës disiplinore “Largim nga puna” të dhënë për shkelje shumë të rëndë, masat e tjera disiplinore shuhën:

a) 1 deri në 6 muaj, pas datës së dhënies së vendimit të masës disiplinore për shkelje të lehta;

b) 6 deri 12 muajve, masat e dhëna për shkelje të rënda;

12. Kjo rregullore miratohet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe mund të ndryshohet me kërkesë të të paktën tre anëtarëve të tij.

Miratuar me vendimin nr. 66, datë 18.11.2019

Tiranë më 18.11.2019

Template 1

Nr.... prot.

Tiranë, më.../.../2019

Lënda: Njoftim i komisionerit, me cilësinë e eprorit direkt të këshilltarit ligjor, për shkelje disiplinore pretenduar ndaj këshilltarit z./znj._____.

Drejtuar: Kryetarit të Komisionit
Mbledhjes së Komisionit

Për dijeni: z/znj_____këshilltar i njësisë së shërbimit ligjor, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

I nderuar Kryetar,

Në cilësinë e eprorit direkt të z/znj_____, në datë...., kam konstatuar se:

- Z./Znj._____ ka vepruar/mosvepruar, me dashje ose nga pakujdesia/neglizhenca, duke....(përshkrim i detajuar i kryerjes së veprimit konkret)
- Shkelja ka ndodhur në këto rrethana dhe bazohet në këto fakte ose sjellje/dëshmitarë.
- Provat që mbështetet pretendimi janë të listuara si më poshtë dhe gjenden bashkëlidhur këtij njoftimi me shkrim:

1....

2....

3.....

Në bazë të nenit..., të ligjit..., të rregullores, kërkoj fillimin e procedimit disiplinor ndaj z./znj._____, këshilltar ligjor/ekonomik dhe caktimin nga mbledhja e Komisionit, të anëtarëve të Komitetit Disiplinor *ad hoc*, për ndjekjen e kësaj procedure.

Epror Direkt

Emër/Mbiemër, **Komisioner**

Template 2.

Nr.....prot.

Tiranë më.../.../2019

Lënda: Njoftim për zhvillimin e seancës dëgjimore

Drejtuar: z/znj_____ këshilltar i njësisë së shërbimit ligjor, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

I/e nderuar z./znj._____

Komiteti disiplinor *ad hoc*, i caktuar me vendim nr...datë.../.../2019, të mbledhjes së Komisionit, ju njofton se në datën, ora....., në zyrën/sallën _____në KPK, do të zhvillohet seanca dëgjimore për shkeljen e pretenduar nga eprori direkt.

Bazuar në njoftimin e eprorit direkt, komisioneri_____, pretendohet se:

- Ju keni kryer veprimin (shkeljen e pretenduar nga eprori dhe rrethanat e kryerjes, e cila bie në kundërshtim me detyrat tuaja funksionale apo ato të caktuara nga komisioneri)

- Këtë pretendim eprori juaj e bazon në provat me shkrim të cilat i gjeni bashkëlidhur.

- Ju keni të drejtën për të paraqitur prapësimet me shkrim dhe provat, si dhe të dëgjoheni nga komiteti disiplinor *ad hoc*.

- Data, ora dhe vendi, ku do të zhvillohet seanca dëgjimore është_____;

Ju keni të drejtë që, brenda **5 ditëve punë** nga marrja e këtij njoftimi, të depozitoni në protokoll-arkivën e KPK-së, prapësimet tuaja me shkrim dhe prova bashkëlidhur, ose t'i paraqisni ato në seancë dëgjimore.

Merrni masat që të jeni prezent në datën... dhe orën _____e seancës dëgjimore, ose të merrni masat në rast mungese (me apo pa arsye), që t'i depozitoni nëpërmjet protokollit prapësimet me shkrim, të paktën një ditë para datës së caktuar për seancën tuaj dëgjimore.

Në rast mungese, të njoftuar nga ana juaj për shkaqe të arsyeshme, seanca dëgjimore mund të shtyhet vetëm një herë, dhe jo më shumë se 3 ditë pune, nga data e parë e caktuar për këtë qëllim. Në të kundërt, mosprezenca juaj, konsiderohet refuzim për t'u dëgjuar.

Ju faleminderit,

Komiteti disiplinor *ad hoc*

Kryetar_____Komisioner

Anëtar_____Komisioner

Anëtar _____Komisioner

Template 3.

Nr.....prot.

Tiranë më.../.../2019

Lënda: Njoftim i përsëritur për zhvillimin e seancës dëgjimore

Drejtuar: z./znj _____ këshilltar i njësisë së shërbimit ligjor, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

I/E nderuar z./znj. _____

Duke marrë parasysh arsyen e mungesës suaj, në datën e caktuar _____, ora _____ për zhvillimin e seancës dëgjimore, komiteti disiplinor *ad hoc*, njofton se data e seancës suaj dëgjimore mund të shtyhet një herë të vetme dhe jo më shumë se 3 ditë nga data e caktuar më parë.

Sa më sipër, lutem merrni masa të jeni prezent në seancë në datën _____ / ____ /2019, (+3 ditë *pune nga data e parë e caktuar*), ora _____.

Në të kundërt, mospjesëmarrja në datën dhe orën e caktuar më sipër, konsiderohet refuzim për t'u dëgjuar nga komiteti disiplinor *ad hoc*.

Ju faleminderit,

Komiteti disiplinor *ad hoc*

Kryetar _____ Komisioner

Anëtar _____ Komisioner

Anëtar _____ Komisioner

Template 4.

Raporti disiplinor që Komiteti i drejton mbledhjes së Komisionit

I. Përmbledhje e procedurës së ndjekur

Përshkrimin e procedurës së ndjekur, rrethanat e faktit, bazën ligjore të shkeljes së pretenduar, provat/materialet e paraqitura nga eprori direkt, prapësimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga këshilltari nën procedim, anën subjektive (me ose pa faj), pasojën e ardhur, pasjen ose jo të masave disiplinore të mëparshme dhe vlerësimin e përgjithshëm të punës, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi dhe këtë rregullore.

II. Propozimi i klasifikimit të shkeljes disiplinore

Sa më sipër, komiteti disiplinor *ad hoc*, propozon klasifikimin e shkeljes disiplinore si “*shkelje të lehtë/ të rëndë/shumë të rëndë*”; të kryer me *faj/neglizhencë/pakujdesi/të përsëritur* (ose jo) dhe pasojën e ardhur në dëm të punës dhe institucionit.

III. Propozimi për dhënien e masës disiplinore “_____”.

Në përputhje me klasifikimin e mësipërm, komiteti disiplinor *ad hoc* propozon edhe dhënien e masës disiplinore “_____” me vendim shumice të votave të anëtarëve prezent në mbledhjen e Komisionit.

Template 5

Vendimi i masës disiplinore